

V E N D I M
Nr.9, datë 12.1.2001

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.406, DATË 17.8.1993, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES
SË BIMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr.7662, dastë 19.1.1993, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.406, datë 17.8.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“ Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, në çdo rreth, caktohen inspektorët e mbrojtjes së bimëve, numri i të cilëve përcaktohet në përputhje me aktet nënligjore, për miratimin e organikave dhe të numrit të punonjësve.

Laboratorët e mbrojtjes së bimëve ngrihen dhe funksionojnë mbi bazë zonale. Numri i zonave dhe vendndodhja e laboratorëve përcaktohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.”.

2. Fjala e parë e paragrafit të dytë, në pikën 3, ndryshohet si vijon:

“Inspektorët e karantinës së jashtme bimore e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pikat doganore, kufitare. Ata janë pjesëtarë të grupit të praktikës, që bën kontaktin e parë.”.

3. Pika 5 ndryshohet si vijon:

“Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të marrë masat për ngritjen dhe plotësimin e laboratorit qendror të karantinës bimore dhe të laboratorit të kontrollit cilësor shtetëror të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, të zyrave të inspektimit karantinor fitosanitar, në pikat doganore, kufitare, dhe të laboratorëve zonalë të mbrojtjes së bimëve.”.

4. Pika 6 shfuqizohet.

5. Pika 9 ndryshohet si vijon:

“Pagesat për shpenzimet administrative të regjistrimit të PMB-ve, shpenzimet për analizat cilësore të tyre, gjatë procedurave të regjistrimit dhe pas hedhjes në treg, dhe shpenzimet për kryerjen e provave biologjike-agronomike bëhen nga llogaria e thesarit për Institutin e Mbrojtjes së Bimëve. Ato administrohen sipas akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, për investime dhe shërbime operative në laboratorin e kontrollit cilësor shtetëror të PMB-ve dhe për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta